



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	
Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution	
Nr./Br./No. <u>362/2024</u>	
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. <u>03/05/2024</u>	
Dati/Datum/Date:	



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 3 maj 2024

Z. Valon Totaj, kryetar
Gjykata e Apelit e Kosovës
Pallati i Drejtësisë, Hajvali
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

A. nr. 563/2021

I nderuari z. Totaj,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 5 tetor 2021 kishte pranuar ankesë nga z. parashtruar kundër Gjykatës së Apelit të Kosovës (GjA), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur në lëndën AC.nr.1159/21, e cila ka të bëjë me kontest pune, përkatësisht shqyrtimi i ankesës të së paditurës Kompania Ujësjellësi Regional “Prishtina” Sh. A., Prishtinë.

Lidhur me këtë rast, vërehet se Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin C.nr.968/2016, datë 13 janar 2020, ia kishte aprovar ankuesit të drejtën për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale. Kundër këtij aktgjykimi, e paditura Kompania Ujësjellësi Regional “Prishtina” Sh. A., Prishtinë, më 19 shkurt 2020 kishte parashtruar ankesë në GjA, e cila lëndë ishte evidentuar me shifren AC.nr.1159/21. Nga informacionet që Avokati i Popullit i ka në dispozicion vërehet se GjA-ja ende nuk ka vendosur lidhur me rastin.

Më 31 janar 2022, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkresa kishte kërkuar informata nga GjA-ja, në lidhje me rastin në fjalë.

Më 8 shkurt 2022, GjA-ja kishte kthyer përgjigje dhe kishte njoftuar Avokatin e Popullit: *“Lënda ende nuk është e kryer, pasi ka rritje të numrit të madh të lëndëve të pranuara në krahasim me vitin paraprak.”*

Më 24 maj dhe më 29 shtator 2022, më 16 mars dhe më 13 korrik 2023, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kishte komunikuar me gjykatën edhe nëpërmjet postës elektronike dhe ia kishte rikujtuar gjykatës nenin 475 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas të cilit përcaktohet se lëndët e kontesteve gjyqësore nga marrëdhënia e punës, në gjykatë janë me prioritet. Lidhur me këtë çështje gjykata kishte dhënë informata: *“Lënda është caktuar tek*

gjyqtari referues dhe lënda ka statusin e lëndës së pakryer, duke pasur parasysh numrin e madh të lëndëve, ku lëndët më të vjetra të vitit 2019 dhe 2020 janë në punë.”

Avokati i Popullit ka vërejtur se në Ligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcaktohet: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përpjekje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.*”

Po ashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur se në Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në nenin 10, paragrafi 1, përcaktohet: “*Gjykata ka për detyrë të përpjeket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.*” Edhe në nenin 475 të këtij ligji përcaktohet: “*Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.*” Prandaj sipas përcaktiveve të mësipërme vërehet se lëndët e kontesteve gjyqësore nga marrëdhënia e punës konsiderohen lëndë me prioritet.

Avokati i Popullit vlerëson se përgjegjësia kryesore për përgatitjen e çështjes dhe për kryerjen e shpejtë të një gjyktimi u takon gjyqtarëve. Lidhur me këtë çështje, GjEDNj-ja ka konstatuar se ndryshimet e përsëritura të gjyqtarëve “nuk mund ta zhveshin shtetin nga përgjegjësia, pasi ai është përgjegjës për të siguruar që administrimi i drejtësisë është organizuar siç duhet”. Ashtu sikurse një “*mbingarkesë kronike*” e gjykatave me çështje nuk i justifikon proceset e tej zgjatura, si shembull mund ta paraqesim rastin lidhur me çështjen *Sociedade de Construções Martins & Vieira, Lda. dhe të tjerët kundër Portugalisë.*

Avokati i Popullit konstaton se zvarritjet e procedurës gjyqësore shkaktojnë pasoja serioze në sundimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Lidhur me këtë çështje, duke pasur parasysh informatat e pranuara nga ankuesi dhe dokumentacionin që Avokati i Popullit e ka në dispozicion, vërehet se lënda AC.nr. 1159/21 e ka statusin e lëndës së pakryer, që nënkupton se ka më shumë se katër vjet e një muaj që gjendet në GjA, e që rrjedhimisht paraqet zvarritje të procedurës gjyqësore.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se zvarritja e një rasti të tillë në gjykatë shkel:

1. të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me KEDNj-në dhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore;
2. të drejtën për mjete efektive juridike, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNj-në;
3. të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.


Prandaj, duke pasur parasysh rrëthanat e theksuara më sipër dhe me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave të theksuara më sipër, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Gjykatës së Apelit të Kosovës:

- *Pa vonesa të mëtejme, t'i ndërmarrë veprimet ligjore lidhur me trajtimin e lëndës AC.nr.1159/21.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekondim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit